

Kalendari Kulturor Korrik 2014



MUZIKË NJË UDHËTIM DREJT EVROPËS

E martë 1 Korrik, ora 20
Teatri i Operas dhe Baletit



Për të përruar fillimin e semestrit të Presidencës italiane të Këshillit të BE, **Instituti Italian i Kulturës, Ambasada Italiane në Shqipëri, Fondacioni IDEA, Shkolla e Muzikës së Fiesole-s**, me mbështetjen e **Ministrit të Kulturës së Shqipërisë** dhe **Teatrit të Operas dhe Baletit në Tiranë**, paraqesin një koncert me muzikë të veçantë përfaqësuese e komponentëve të ndryshëm të identitetit evropian. Aktiviteti bashkon, për herë të dytë në Shqipëri, muzikantë italianë dhe shqiptarë të **Orkestrës Rinore Italiane** dhe asaj **Shqiptare**, nën drejtimin e M^o **Guido Corti**. Drejtorë artistikë **Pëllumb Vorpsi, Arbër Neziri**.

Në program:

Rossini "L'Italiana in Algeri" Overture;
Haydn Sinfonia n. 104 in Re maggiore (London);
Bartok Danze Rumene;
Brahms Danze Ungheresi 1,4,5,

Guido Corti, pasi përfundoi studimet në Itali, u perfeksionua në Çikago me Dale Clevenger dhe Arnold Jacobs. Është fitues i konkursit ndërkombëtar në Colmar (Francë), ka realizuar regjistrime radiofonike dhe televizive për rrjete të ndryshme evropiane dhe amerikane, duke ndërmarrë një veprimtari që më pas e çoi në skenat e gjithë botës. Në Itali është i ftuar nga shoqëritë koncertore më të rëndësishme të tilla si RAI, Maggio Musicale Fiorentino, Orchestra della Toscana, Estate Fiesolana... Aktualisht është profesor në Konservatorin e Muzikës **L. Cherubini** në Firenze dhe komponent i ansambleve të ndryshme të dhomës, duke përfshirë edhe prestigjiozen **Mullova Ensemble**.

MUZIKË Edicioni i 1^o i Festivalit të Muzikës Antike NGA ITALIA ALBANIAN BAROQUE ENSEMBLE

5, 8, 10 dhe 12 Korrik
Durrës, Tiranë, Shkodër, Korçë




Pjesëmarrje në *Albanian Baroque Ensemble* (Marco Lazzara - controtenore, Jusuf Beshiri - klavicembalo, Perikli Pite - viola da gamba, Daorsa Dervishi - flaut) i përbërë nga **muzikantë italianë dhe shqiptarë** të formuar në Itali, në edicionin e parë të Festivalit të VOX BAROQUE me muzikë antike, organizuar nga Shoqata Kulturore Artistike *Jan Kukuzeli*. Me qëllim përhapjen e muzikës baroke, një lëvizje kulturore lindur në Itali, orkestra do të japë disa koncerte me instrumenta të vjetër, duke propozuar një program të kompozitorëve italianë si **Barsanti, Piani, Vinci, Poropora** dhe **Vivaldi** dhe dy pjesë, një nga **Hendel** (kompozitor që ka jetuar gjatë në Itali) dhe një nga **Bach**, si dy nga pikat mbështetëse shumë interesante dhe të rëndësishme për të nxjerrë në pah edhe më shumë bukurinë dhe rëndësinë e muzikës dhe stilit italian në botë.

Do të vijojë Kalendari i koncerteve

EKSPOZITË Projekti Kufijtë: gjuhë, hapësirë, objekte, njerëz QËNDRO MË THE DHE UNË QËNDROVA e Agnese Purgatorio

E enjte, 3 Korrik, Ora 18.30
Hall, kati II, Pallati i Kulturës

Me rastin e Presidencës italiane të Bashkimit Evropian, **Instituti Italian i Kulturës në Tiranë**, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Institutet Italiane të Kulturës së Këlnit, Strasburgut dhe Zagrebit do të paraqesë në Tiranë projektin ekspozues të artit bashkohor **Kufijtë: gjuhë, hapësirë, objekte, njerëz**, konceptuar dhe kuruar nga Prof. **Martina Corgnati** e Akademisë Albertina në Torino. Artistët e përfshirë, të cilët do të ekspozojnë njëri pas tjetrit në katër Institutet janë: Agnese Purgatorio, Agostino Ferrari, Donatella Spaziani dhe Maria Cristina Carlini. Projekti fillon në Tiranë me ekspozitën personale - me prerje antologjike - të **Agnese Purgatorio**. Artistja, e cila prej vitesh punon mbi temën e mërgimit dhe klandestinitetit, duke u përballur në mënyrë sistematike me idenë, reale dhe metaforike, të kufirit si rrugë e shënuar nga historia në trupin e gjallë të gjeografisë, është veçanërisht e përshtatshme të kthejë, përmes veprave të saj, idenë dhe temën e "hapësirave" që përbëjnë një nga katër polarizimet e projektit. Në ekspozitë shfaqen 12 vepra dhe një video instalim. Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri më 21 gusht.



FOTOGRAFIA Ditët e fotografisë italiane në Tiranë

TAKIM ME OLIVIERO TOSCANI

E hënë, 14 Korrik, ora 18.30

Konferencë shtypi ora 18

Salla Nënë Tereza, Pallati i Kulturës

Takimi i 2^o në kuadër të projektit **Ditët e fotografisë italiane në Tiranë** realizuar nga **Instituti Italian i Kulturës** dhe **EJAlbum**, ofron për të apasionuarit takimin me fotografimin me famë ndërkombëtare **Oliviero Toscani**.

Artist, djali i fotoreporterit të parë të Corriere della Sera, është i njohur në botë si forca krijuese prapa emrave të gazetave më të famshme dhe markave të botës, krijues i imazheve të korporatave dhe fushatave publicitare. Pas gati pesë dekadash risie editoriale, reklamash, filmash dhe televizioni, aktualisht merret me krijimtarinë e komunikimit të aplikuar në media të ndryshme, duke prodhuar me studion e tij, projekte editoriale, libra, programe televizive, ekspozita dhe kompozime. Ka fituar çmime të shumta, si katër Luanë të Artë, Çmimin e Madh të UNESCO-s dhe çmime të shumta të Art Directors Club të të gjithë botës.



MUZIKË Edicioni i 3-të Jazz in Albania Festival

MARCO CASTELLI TRIO

E enjte 24 Korrik, ora 20, Hotel Sheraton, Tiranë

E premte, 25 Korrik, ora 20, Pedonale, Shkodër



Italia merr pjesë në Festivalin e 3-të Ndërkombëtar të Jazz-it në Shqipëri, të drejtuar nga Besim Petrela - Shoqata Syri Blu - me të jashtëzakonshmin **MARCO CASTELLI TRIO** (Marco Castelli, saksofon; Matteo Alfonso, organo; Marco Vattovani, bateri). Një grup me dhunti të shumta që ofron një përzierje të jazz-it me zhanre të tjera muzikore si afrikane, *ska* dhe ritme latine duke i përzierë në një matricë të vetëm mesdhetare. Repertori, përveç pjesëve të lidhura më ngushtë me traditën e jazzit, përfshin gjithashtu kompozime origjinale të Marco Castelli-t dhe orkestrime të tipit jazz të autorëve të këngëve tradicionale italiane.

Marco Castelli është saksofonist, kompozitor, orkestrues, prodhues dhe drejtori i Big Band. Përveç koncerteve në Itali, Marco Castelli dallon mes muzikantëve të jazz-it italian për aktivitetet mbresëlënëse në festivale ndërkombëtare dhe turne në të gjithë botën.

Matteo Alfonso, pianist, kompozitor, i cili ka bashkëpunuar me Eliot Zigmund dhe Pietro Tonolo, duke marrë pjesë në disa festivale dhe koncerte. Në vitin 2001 fitoi çmimin e kritikës si "Miglior Nuovo Talento" në konkursin kombëtar "Baronissi Jazz" (SA). Është profesor i piano jazz në Konservatorin "G. Tartini" të Triestes.

Marco Vattovani, baterist eklektik, ka bashkëpunuar me artistë dhe projekte muzikore si në muzikë komerciale ashtu dhe në muzikën jazz dhe në muzikë autorësh duke interpretuar me shumë muzikantë si italianë dhe të huajt si Robben Ford, Jayla Brown, Eddie Cat, Al Castellana.